

DEKRET
Nr. 459, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e dekoratës “Kalorës i Urdhrit të Lisit Akademik” zotit Gjovalin Bica

“Në shenjë vlerësimi për përkushtimin e jashtëzakonshëm ndaj arsimit në një zonë të thellë malore, për sakrificën e përditshme dhe përkushtimin profesional në shërbim të arsimit. Në nderim të qëndresës, integritetit dhe besimit të palëkundur në misionin e arsimitarit, duke përfaqësuar modelin e mësuesit që sfidon vështirësitë dhe mban gjallë dritën e dijes në çdo skaj të vendit”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj